



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT NË KOSOVË
APELACIONI SUD KOSOVO – COURT OF APPEALS

APS.nr.10/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT NË KOSOVË – Departamenti Special, në Kolegjin Penal të përbërë nga gjyqtarët, Vatton Durguti – Kryetar i kolegjit, Burim Ademi dhe Kreshnik Radoniqi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor, Bajram Rexhahmetaj si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të pandehurit F.M.. nga Fushë Kosova për shkak të veprës penale Dhënie e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 të KPRK-ës, duke vendosur lidhur me ankesën e mbrojtësit të pandehurit F.M.. av.Blerim Çela, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti i Krimeve të Rënda në Prishtinë PKR.nr.181/18 të dt. 13.05.2019, dhe përgjigjes në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.48/2015 të datës 24.07.2019, me datë. 14.10.2019 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të pandehurit F.M.. av. Blerim Çela, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore- Departamenti i Krimeve të Rënda në Prishtinë PKR.nr.181/18 të dt. 13.05.2019, vërtetohet.

Arsyetim

Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Krime të rënda, ka marrë aktgjykimin PKR.nr.181/18 të datës 13.05.2019, me të cilin e ka shpallur fajtor të pandehurin F.M.. për shkak të veprës penale Dhënie e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale nga neni 388 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i KPRK-ës, dhe e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, në të cilin dënim i ka llogaritur edhe kohën e kaluar nën masën e paraburgimit nga data 11.07.2015 e gjerë me datë 16.04.2018, po ashtu e ka detyruar të pandehurin që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë paushallin gjyqësor në lartësi prej 50 euro në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, ka parashtruar ankesë mbrojtësi i të pandehurit F.M.. av. Blerim Çela për shkak të; shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj si të bazuar, ashtu që ta anuloj aktgjykimi i ankimuar ashtu që kjo çështje penale të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, apo që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe i pandehuri të lirohet nga akuza për veprën penale që është akuzuar.

Prokuroria Speciale e Kosovës, ka parashtruar përgjigje në ankesën e mbrojtjes së të pandehurit, PPS.nr.48/2015 të datës 24.07.2019, me të cilën përgjigje ka propozuar që Gjykata e Apelit ta vërtetoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ndërsa ankesën e mbrojtësit të të pandehurit ta refuzoi si të pabazuar, duke theksuar se aktgjykimi është mbështetur në provat që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor dhe mbi të cilat prova ka rezultuar edhe faëjsia e të pandehurit për veprën penale që është akuzuar.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, ka paraqitur parashtresën me shkrim PPA/I.nr.389/2019 të datës 10.09.2019, me të cilën ka propozuar që Gjykata e Apelit ta refuzojë si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit F.M.. av. Blerim Çela të aprovohet përgjigja e prokurorisë Speciale dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit ka caktuar seancën e kolegjit në të cilën i ka njoftuar palët për mbajtjen e seancës, e në të cilën seancë kanë marrë pjesë, i pandehuri F.M.. dhe mbrojtësi i tij av. Blerim Çela ndërsa nuk ka prezantuar Prokurori i Apelit edhe pse është njoftuar me rregull për kohën e mbajtjes së seancës.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të Mbrojtjes, përgjigjen e prokurorisë speciale, propozimin e Prokurorisë së Apelit, duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

Ankesa e Mbrojtësit të të pandehurit F.M.. av. Blerim Çela për shkaqet si në vijim është e **pabazuar**:

1. Pretendimet e mbrojtjes lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave procedurale dhe gjetjet e gjykatës:

Mbrojtja pretendon se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përfshihet me shkelje esenciale të dispozitave procedurale, duke theksuar se aktgjykimi mbështetet në prova të papranueshme duke ua falur besimin provave fajësuese, ndërsa koncentrohet në deklarimin e vet të pandehurit kur thotë se: “ Punoj si taksist i licencuar me emrin M.T.... i dhe se natën kritike u kam shërbyer G. dhe B. me të cilët njihem edhe më herët, dhe pas dërgimit të tyre në destinacion nuk më kanë paguar sepse nuk kishin para por pagesën do të ma bënin një

ditë tjetër”, theksohet se kjo provë nuk mundë të shërbej për të mbështetur aktgjykimin gjykata e shkallës së parë e posaçërisht nga fakti se i pandehuri F.M.. ka theksuar se nuk e ka ditur qëllimin e qëndrimit të të bashkë akuzuarve tek Liqeni i Badovcit, ngase të njëjtit i kanë thënë se kanë shkuar për të falur namaz nate, po ashtu edhe i pandehuri B.I. ka theksuar në polici dhe prokurori se F.M.. nuk ka ditur asgjë lidhur me qëndrimin tonë tek Liqeni i Badovcit, e ndërsa i pandehuri G.H. është mbrojtur në heshtje. Gjykata ka marrë aktgjykim dënues përkundër se provat kanë krijuar një situatë të qartë në bazë të shkresave të lëndës, në këtë rast gjykata nuk ka zbatuar parimin sipas nenit 3 paragrafi 2 i KPP-ës, pasi që mëdyshjet duhet të interpretohen në favor të të pandehurit kur ato ekzistojnë, andaj nëse ka pasur mëdyshje të tilla gjykata e shkallës së parë nuk i ka interpretuar sipas dispozitës së theksuar, gjykata gabimisht nuk i falë besimin të pandehurit F.M.. se ai ishte vetëm taksist dhe jo kryerës i veprës penale për të cilën është dënuar.

Gjetjet e gjykatës për sa i përket këtyre pretendimeve:

Gjykata e apelit duke i vlerësuar pretendimet ankimore të mbrojtjes së të pandehurit për shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, por duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare në mbështetje të nenit 394 paragrafi 1 i KPP-ës, gjen se pretendimet ankimore nuk janë të bazuara, por edhe sipas detyrës zyrtare nuk konstatohen shkelje të dispozitave të procedurës penale.

Mbrojtja nuk specifikon ndonjë shkelje konkrete të dispozitave të procedurës penale, por më tepër referohet në raport me vlersimet dhe besimin e provave që gjykata e shkallës së parë e ka bërë për të vërtetuar faktet e caktuara të kësaj çështje penale. Fillimisht kjo gjykate konstaton se nuk kemi të bëjmë me provë të papranueshme për sa i përket deklaratës së të pandehurit kur ai thekson se: “ jam taksist dhe kam shkuar e iu kam shërbyer G.it dhe B.t por që nuk më kanë paguar nga se nuk kanë pasur të holla”, këtu kemi të bëjmë me vlerësimin e provës – pra se çfarë në të vërtetë provon kjo deklaratë e të pandehurit F. ne raport me rrethanat faktike, gjykata rikujton se për tu konsideruar se kemi të bëjmë me papranueshmërin e provave ajo duhet të jetë siguruar në kundërshtim me dispozitatat ligjore të KPP-eë, e qe në rastin konkret deklarata e të pandehurit nuk është marrë në kundërshtim me dispozitatat ligjore andaj për keto shkaqe nuk kemi të bëjmë me prova të papranueshme por kemi të bëjmë me aspektin e vlerësimit të provave nga gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit, i akcepton arsyet që janë theksuar nga gjykata e shkallës së parë dhe vlerësimi që i është dhënë deklaratës së të pandehurit F.M.. për këto rrethana që i konteston mbrojtja, pasi që siç rezulton nga arsyetimi i aktgjykimimit të gjykatës së shkallës së parë kjo deklaratë është ndërlidhur me provat tjera për të ardhur në konkludimet e tilla që janë dhënë ne aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e të cilat edhe kjo gjykatë i vlerëson si të pranueshme.

Lidhur me pretendimet që theksohen nga mbrojtja se në rast se ka pasur mëdyshje për ekzistimin e fakteve ato është dashur të interpretohen në favor të të pandehurit e që vlerësohet nga mbrojtja se i pandehuri nuk ishte në dijeni për qëndrimin e të bashkakuzuarve tek Liqeni i Badovcit, Gjykata e Apelit vëren se në të vërtet nga dispozitivi i aktgjyqimit por edhe arsytet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë lidhur me këtë gjendje faktike nuk bëhet fjale për ekzistimin e mëdyshjeve nëse fakti konkret ka ekzistuar apo nuk ka ekzistuar, pasi që gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme e te cilat arsye janë theksuar se mbi cilat prova mbështeten ato, duke nxjerrë edhe konkludim si në aktgjykim e të cilat konkludime i akcepton edhe Gjykata e Apelit, për rrethanën e dijenisë kjo gjykate rikujton se ajo duhet të rezultojë në bazë të rrethanave faktike, dhe si premisë e tillë ligjore që kërkohet gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye kur edhe ka konstatuar se i pandehuri ka vepruar me qëllim siç përshkruhet në dispozitiv, e megjithatë për rrethanën e qëllimit dhe dijenisë kjo gjykate do të jap arsye më në detaje tek pjesa e arsyetimit që lidhet me gjendjen faktike.

Andaj për këto arsye Gjykata e Apelit nuk i gjen të bazuara pretendimet ankimore të mbrojtjes se kemi të bëjmë me shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale e po ashtu as sipas detyrës zyrtare nuk rezulton se aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

2.Pretendimet ankimore lidhur me vërtetimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike:

Mbrojtja pretendon se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes së fakteve ashtu siç përcaktohet me nenin 386 të KPRK-ës, duke theksuar se shërbimin qe e ka bërë i pandehuri F.M.. në cilësin e taksistit nuk ka qenë dhënie e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprës penale pasi që kur ata kanë hipur në veturë i ka pyetur se përse ishin te Liqeni i Badovcit, dhe te njëjtit iu kanë përgjigjur se ishin për ta falur namazin e natës dhe për të ngrënë Syfyrin, duke mos pasur asnjë dyshim më të vogël se ishin për ndonjë qëllim tjetër tek liqeni, se edhe pas arrestimit të të pandehurit F.M.. i njëjti ka qenë bashkëpunues me policinë, prokurorin dhe gjykatën dhe i njëjti ka pohuar se është me besim musliman dhe të gjithë besimtarët i ka vëllezër, e që gjykata fjalën “vëllezër” e kupton gabimisht duke e marre si provë nga gjykata për ta dënuar për veprën penale që në asnjë formë nuk e ka kryer, e kjo më së miri vërtetohet me ricilesimet e njëpasnjëshme nga ana e vet prokurorisë speciale pasi që vet prokuroria nuk ishte në gjendje të përcaktoj qartë veprimet inkriminuese të të pandehurit.

Gjetjet e gjykatës:

Gjykata e Apelit vëren se mbrojtja në esencë nuk konteston një mori rrethanash faktike përmes ankesës e siç rezulton nuk janë kontestuar as në shqyrtimin gjyqësor, pra

mbrojtja nuk konteston faktet se: “ *I Akuzuari me date. 11.07.2015 pas orës 02:00 te mëngjesit ka shkuar tek liqeni i Badovcit sipas ftesës së të akzuarit G.H. g.h.me veturën e tij Golf 4 i ka transportuar të akzuarit G.H. deri në shtëpinë e tij ne Hajvali, ndërsa të Akzuarin B.I. i cili gjendet në arrati e ka dërguar deri në shtëpinë e tij në Istog të cilët ishin duke u arratisur nga policia me atë rastë të njëjtëve iu ka mundësuar që të shmangen nga vendi i ngjarjes dhe nga arrestimi i policisë”, nga ankesa dhe nga procesverbalet e shqyrtimit gjyqësor rezulton se mbrojtja për sa i përket gjendjes faktike pretendon vetëm në faktin se: “ i pandehuri F.M.. nuk veproi me qëllim të ndihmës ndaj kryerësve të veprave penale që ka të bëjë me terrorizëm nga se sipas mbrojtjes ai nuk ishte në dijeni të veprimeve të të pandehurve (G.H., B.I. dhe të tjerëve).*

Gjykata e Apelit ka parasysh faktin se, dispozita ligjore e nenit 22 te KPRK-ës, ka përcaktuar se: “ Dijenia, dashja, pakujdesia apo qëllimi si element i veprës penale mundë të nxirret nga rrethanat faktike”, andaj kjo gjykate duke pasur për baze këto pretendime do te japë arsyet lidhur me gjetjet e gjykatës së shkallës së parë dhe pretendimet ankimore mbështetur në këtë dispozitë ligjore.

Siç rezulton nga arsyet e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë në faqen 7 arsyetohet aspekti i dijenisë së të pandehurit lidhur me rrethanat e veprimit të tij, të cilat arsye i akcepton edhe kjo gjykate, megjithatë kjo gjykate vlerëson disa rrethana po ashtu që qojnë në të vetmin konkluzion pra se i pandehuri F.M.. ishte në dijeni dhe veproi me qëllim, si fakt i parë që nuk mohohet nga i pandehuri është fakti se ai njihej me të pandehurin G. por e njihte edhe të pandehurin B., faktin se i pandehuri F. e njihte të pandehurin G. e pohon vet i pandehuri F. se e njoh më parë para ditës kritike, Faktin se e njihte edhe të pandehurin B. po ashtu rezulton për këtë gjykatë edhe nga deklarata e të pandehurit F. kur thekson; “ G.i më ka thënë qe ky është B. dhe unë e kam puthur në ballë e po ashtu kur ai pohon se unë kamë qenë në dijeni që B. ishte nën masën e arrestit shtëpiak”, faktin se G.i e kishte thirrur dhe e kishte pyetur se “ku je” përkundër se ai njëherë e kishte thirr dhe i kishte thënë “hajde merrna te Badovci”, po ashtu fakti se i pandehuri edhe kur ishte afruar tek Liqeni, prapë i pandehuri G. e telefonon dhe i thotë: “ kthehu se të pushë”, pastaj kur e pyet se: “ a vërejte polic”, pastaj fakti se në rrethana normale një taksist vepron me pasagjeret në mënyra normale ku merr udhëtarët normalisht dhe jo buze rrugës, posaçërisht kur taksisti ftohet për të bërë bartjen e pasagjerëve, pastaj faktin se të pandehurin G. e dërgon në shtëpi ndërsa të pandehurin B. e dërgon në Istog – banimin e tij, gjë që nga liqeni i Badovcit deri në Istog është bukur një rrugëtim i gjatë, pastaj faktin se përkundër që pohohet se punoj për familjen, ditën kritike përkundër të gjitha këtyre rrethanave vet i pandehuri pohon se G.i dhe B. nuk më kanë paguar, pastaj faktin se kur i pandehuri G. e pyet të pandehurin F. se a ka parë policë, ku i pandehuri F. i pohon se kishte parë policë dhe pastaj faktin se i pandehuri G. i kishte pohuar se kishte probleme. Të gjitha këto rrethana siç janë arsyetuar në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë edhe për këtë

gjykatë qojnë vetëm në një konkludim dhe nuk mundë të nxjerrët asnjë përfundim tjetër, se i pandehuri F.M.. ishte në dijeni të veprimeve të të pandehurve tjerë tek Liqeni i Badovcit dhe ai veproj me qëllim për ti ndihmuar të pandehurve dhe konkuldimi i tillë është tërësisht ne përputhje me nenin 22 te KPRK-es.

Lidhur me pretendimet se i pandehuri F.M.. nuk ka qenë në dijeni pasi që i kishte pyetur të bashkakuzuarit përse keni dalur tek liqeni, siç ka arsyetuar gjykata e shkallës së parë një arsyetim të tillë e pranon edhe kjo gjykatë se kjo pjesë e deklarimit nga i pandehuri F. bie në kundërshtim të plotë me të gjitha rrethanat e fakteve por edhe me provat që rezultojnë siq janë, telekomunikimi i të pandehurit me të bashkakuzuarin G., por edhe me vet veprimet e të pandehurit e posaçërisht me faktin se i pandehuri F. kishte njohje me G.in që më parë por dinte për aktivitetin edhe të B.t.

Lidhur me pretendimin se gjykata e shkallës së parë fjalën “ vëlla” e keqkupton dhe e vlerëson si provë për ta dënuar të pandehurin, është fakt se kjo fjale citohet në arsyet e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, kjo gjykate rikujton se fjala e tillë në arsyet e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë askund nuk theksohet se ishte ky pohimi i të pandehurit që mbështetet gjykata me rastin e përcaktimit të fajësisë së të pandehurit F.M., por vetëm theksohet ne kontekst të korrektësisë së deklarimeve nga vet i pandehuri në procedurën gjyqësore.

Prandaj për arsyet e theksuara kjo gjykate i gjen si te pabazuara pretendimet ankimore se kemi te bëjmë me vërtetimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, e duke konstatuar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përfshinë vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, të cilat arsye të dhëna edhe gjykata e Apelit i akcepton për sa i përket gjendjes së vërtetuar të fakteve nga gjykata e shkallës së parë.

3. Pretendimet ankimore për sa i përket shkeljes se ligjit penal.

Mbrojtja pretendon se gjykata ka bërë shpërputhje të nenit 385 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 e me atë rast në situatën konkrete janë dëshmuar dhe plotësuar të gjitha rrethanat që përjashtojnë përgjegjësinë penale, se aktakuza mbështetet në dyshimin e bazuar të mirë e ku pastaj përmes provave gjykata duhet ta vërtetoj ekzistimin e atij dyshimi të bazuar të mire, përkundër se janë bërë të gjitha veprimet si këqyrja e vendit të ngjarjes duke u marrë gjurme të gishtërinjve pastaj deklarimi i të gjithë dëshmitarëve, por asnjëra dëshmi nuk kishte fuqinë e provës fajësuese në të cilën do të mundë të mbështetej aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Se i pandehuri nuk kishte interes për tu përfshirë në veprime të tilla pasi që ai ka punën e tij dhe mban familjen dhe ai nuk ishte në dijeni të faktit për takimin që ishte tek Liqeni i Badovcit dhe nuk ishte planifikuar fare që ai të ishte taksist i tyre por kjo ishte bërë e nevojshme dhe e domosdoshme kur i bashkakuzuari G. e thirr disa herë që të shkoj tek liqeni për ti dërguar në shtëpinë e tyre, andaj nga shkresat e çështjes penale nuk mundë të rezultojë fajësia e të pandehurit dhe po ashtu dënimi ndaj tij.

Gjetjet e gjykatës:

Gjykata e apelit rikujton se në rrethanat e kësaj çështje penale nuk mundë të bëhet fjalë për përjashtimin e përgjegjësive penale e që elementet e përgjegjësive penale janë inkorporuara në nenin 17 të KPRK-ës, pasi që përgjegjësia penale ka në vetvete dy elemente, *aspektin e vetive të caktuara psikike të kryerësit pra që konsiston në aftësinë mendore*, lidhur me këtë element të aftësisë mendore të të pandehurit që ndërlidhet me pretendimin ankimor kjo gjykatë rikujton se në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë që do të mundë të qonte në çfarëdo mëdyshje se kemi të bëjmë me paaftësi mendore përkatësisht me ndonjë çrregullim mendor, po ashtu përgjegjësia penale ka në vetvete edhe *elementin e dashjes apo pakujdesisë* që lidhen me fajësinë e të pandehurit gjithnjë sipas nenit 17, mbi këtë baze duke konstatuar se nga veprimet e të pandehurit ka rezultuar ekzistimi i dijenisë dhe qëllimit që të dy këto elemente janë elemente subjektive që ndërlidhen me dashjen e të pandehurit, andaj nga ky këndvështrim kjo gjykate konstaton se në të vërtetë elementet e përgjegjësive penale tek i pandehuri ekzistojnë e që ka konstatuar edhe gjykata e shkallës së parë kur të pandehurin e ka shpallur fajtor, dhe se veprimi i të pandehurit duke qenë në dijeni të rrethanave dhe duke vepruar me qëllim për t'iu ndihmuar të bashkakuzuarve pas kryerjes së veprës penale shpërfaqin elementin subjektiv që është dashja e të pandehurit, për këto arsye kjo gjykate konstaton se i pandehuri kishte vepruar me dashje, dhe në rrethana të tilla pretendimi se kemi të bëjmë me rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale nuk është i qëndrueshëm dhe i bazuar.

Gjykata e Apelit duke vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore për sa i përket kësaj baze ligjore të ankimit nuk i gjen këto pretendime si të bazuara, kjo për faktin se jo domosdoshmërisht përgjegjësia penale dhe fajësia duhet të rezultoj vetëm duke u mbështetur në provat e drejtpërdrejta, pasi që kodit penal dhe procedural nuk përjashton në asnjë rrethanë konstatimin e fajësisë dhe përgjegjësive penale duke u mbështetur në rrethana të tjera faktike edhe pa ndonjë provë të ndërlidhur direkte, megjithatë në këtë çështje penale kjo gjykate rikujton se janë administruar provat dhe po ashtu raportin e telekomunikimeve ku qartësisht rezulton se ka pasur kontakte ditën kritike ndërmjet të pandehurit dhe të bashkakuzuarve, se nga rrethanat e fakteve që nuk mohohen as nga vet i pandehuri siç janë konstatuar në arsyet si më lartë për (vërtetimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike) rezulton se i pandehuri ishte në dijeni dhe kishte vepruar me qëllim, mbi këto baza nuk mundë të gjenden si pretendime të bazuara ankimore theksimet se asnjë dëshmi nuk e kishte fuqinë e provës fajësuese.

Për te gjitha këto arsye gjykata e apelit, vlerëson se pretendimet ankimore se kemi të bëjmë me shkeljen e ligjit penal nuk janë të bazuara.

Gjykata e Apelit duke qenë në dijeni të rrethanave nga shkresat e lëndës se kjo çështje penale ishte në rigjykim, dhe meqenëse kemi ri cilësim në asnjë rrethanë nuk mundë të bëhet fjalë për cenimin e parimit të reformatio in peius.

Gjykata e Apelit kishte parasysh rrethanat që kanë të bëjnë me llojin dhe lartësinë e dënimit në këtë çështje penale, përkundër se mbrojtja nuk i referohet rrethanave të tilla, megjithatë bazuar në nenin 396 të KPP-ës, për Gjykatën e Apelit rrethanat që janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit janë të pranueshme dhe i konsideron edhe kjo gjykatë, duke mos rezultuar për këtë gjykatë ndonjë rrethanë e veçantë që do të mundë të ndikonte në dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit.

Andaj Gjykata për arsyet e lartë theksuara e duke u bazuar në nenin 401 të Kodit të procedurës penale vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT NË KOSOVË
APS.10/2019, më datë.14.10.2019

Procesmbajtës
Bajram Rexhahmetaj

Anëtarët e kolegjit
Burim Ademi

Kreshnik Radoniqi

Kryetari i kolegjit,
Vaton Durguti
